



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 15, datë 22.01.2021

PËR CAKTIM TË PËRKOHSHËM

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 59 pika 1 dhe 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa a të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, dhe në Rregulloren “Për caktimin e përkohshëm të prokurorëve” miratuar me Vendimin nr. 64, datë 15.04.2019 të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, e ndryshuar, me propozim të Komisionit për Zhvillimin e Karrierës,

V E N D O S I:

1. **Z. Erion Çela**, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë, të caktohet përkohësisht të ushtrojë funksionin e prokurorit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.
2. **Z. Erion Çela**, do të ushtrojë detyrën si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, nga data 27.01.2021 - 26.04.2021.
3. Të njoftohen për këtë vendim **Z. Erion Çela**, Prokurori i Përgjithshëm, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETARI  
GENT IBRAHIMI

ANËTAR  
KOSTAQ BELURI

ANËTAR  
SANDËR BECI

ANËTAR  
BUJAR SHESHI

ANËTAR  
VATË STAKA

ANËTAR  
ESMERALDA KESHI

ZV/KRYETAR  
ALFRED BALLA

ANËTAR  
NURIHAN SEITI

ANËTAR  
TARTAR BAZAJ

